REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KRYETARI

Nr.7583,Prot **Ersekë më, 17 / 11 2026**

KËRKESË

Drejtuar: **Asamblesë dhe Komitetit Drejtues të Akademisë së Trajnimit për Vetëqeverisjen Vendore (TALGA)**
Adresa Provizore: Rr. "Brigada VIII", Nd.19. H.4, Tiranë

Lënda: **Kërkesë për anëtarësim të Bashkisë Kolonjë në subjektin e kompetencave të përbashkëta "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)".**

Baza ligjore: Nenit 2 pika 11, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b" dhe nënpika 1.6 shkronja "b", nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54 shkronja "d" dhe "gj", neni 64 shkronja "h", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar); Ligji Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore"; Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Autorizimin e Ministrit Përgjegjës Për Cështjet Vendore për Negocimin dhe Nënshkrimin e Marrëveshjes me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Për Krijimin e Personit Juridik si Subjekt i Kompetencave Të Përbashkëta me Vetëqeverisjen Vendore Për Rritjen e Kapaciteteve Të Qeverisjes Vendore Të Republikës Së Shqipërisë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak; Vendimi i Këshillit Bashkiak të nr. 95 datë 29/ 08 / 2025.

Të Nderuar Drejtues dhe Anëtarë të Asamblesë së TALGA-s,

Këshilli i Bashkisë Kolonjë me vendimin e tij VKB Nr. 95, datë 29/ 08 / 2025 ka miratuar

anëtarësimin e Bashkisë Kolonjë në personin juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA)", përmes miratimit të marrëveshjes për krijimin e TALGA-s, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, si dhe miratimit të aktin e themelimit të TALGA-s, sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s, si dhe ka miratuar efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Kolonjë si anëtare e TALGA dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027. Përmes këtij VKB, Këshilli ka autorizuar Kryetarin e Bashkisë Kolonjë të nënshkruaj të gjitha dokumentet administrative për anëtarësimin në TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s, si dhe ka autorizuar Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Kolonjë në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Kolonjë nga anëtarësimi në TALGA.

Përsa me sipër, në emër të Bashkisë Kolonjë i kërkoj Asamblesë dhe Komitetit Drejtues të TALGA-s:

1. Anëtarësimin e Bashkisë Kolonjë në TALGA, si dhe
2. Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për nënshkrimin e Statutit të TALGA-s.

Përzemërsisht,

ERION ISAI

Kryetari i Bashkisë Kolonjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KOLONJË